

VENDIM
Nr. 32, datë 20.1.2021

PËR KRYERJEN E PARAPAGIMIT TË DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË PAGESAVE PËRKATËSE, QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E NËNSHKRUAR PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE LIGJIN NR. 3/2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”; të aktit normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik”, të miratuar me ligjin nr. 3/2021, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të:
 - a) parapagimit të dozave të vaksinave anti-COVID-19;
 - b) pagesave përkatëse, si kostot për transportin, ruajtjen, magazinimin, shpërndarjen, përdorimin në popullatë të vaksinës dhe fushatën e vaksinimit.
 2. Pagesat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 3/2021.
 3. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në programin “Shërbime të shëndetit publik”, t’i shtohet fondi në shumën e përcaktuar në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.
 4. Fondi sipas pikës 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.
 5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe